



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Prilapjen Me Data: 18-09-2024			
Nr. Dokumenti Llog. Dena	Nomeni Dreg	Shtepit Drejtues	Vlera Vendosist
01	016/01-		1113



Komuna e Vitisë

Drejtoria për Financa Ekonomi dhe Zhvillim

Informatë lidhur me Raportin e auditimit për Pasqyrat Financiare të Komunës së Vitisë për vitin e përfunduar më 31.12.2023

Duke u bazuar në Ligjin mbi Menagjimin e Financave Publike dhe Përgjegjstitë Ligji Nr. 03/L-048 (plotësim ndryshimet në Ligjin Nr.03/L-221 ,Ligjin nr.04/L-116, Ligjin nr .04/L-194, Ligjin nr .05/L-063, Ligjin nr. 05/L-007) Neni 45 dhe neni 46 (neni 46 paragrafi 46.2) që obligojnë organizatat buxhetore të përgatisin Raporte tremujore respektivisht raport përfundimtar për vitin e kaluar kalendarik.

Mandej duke u bazuar në Rregullore MF-NR.01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga organizatat buxhetore – Neni 4 obligimet e raportimit të organizatave buxhetore (Organizatat Buxhetore janë të obliguara të përgatisin dhe të dorëzojnë Pasqyrat Vjetore Financiare në MF-Departamentin e thesarit , Neni 5 afatet kohore për dorëzimin e Pasqyrave Financiare Vjetore dorëzohen brenda afatit prej 30 ditë nga përfundimi i vitit fiskal në formë të shtypur dhe në formën elektronike.

Ne si drejtori ju kemi përmbajtur Ligjit dhe rregullores në fuqi dhe i kemi përgatitur duke u bazuar në regjistrin kontabël të thesarit në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit në sektorin publik e dorëzuar në kohë më 30.01.2024 e korigjuar me datë 23.02.2024.

Auditimin e Pasqyrave Vjetore Financiare për vitin e përfunduar Janar- Dhjetor 2023 e ka kryer ,, Zyra Kombëtare e Auditimit,, ka filluar auditimin në muajin dhjetor 2023 faza e parë dhe në muajin mars 2024 faza e dytë me zyrtarët - auditori i ZKA-së Arian Gaxha udhëheqës i ekipit, Ymer Vitia anëtar i ekipit, Ermira Isufi- anëtare i ekipit , nën menagjimin e drejtorit të auditimit Lavdim Maxhuni .

Zyra e kombëtare e auditimit është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar , kryen auditime të rregullsis dhe të performancës, që është në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNAISA).

Misioni i ZKA-së është që të kontribojmë në menagjim të shëndosh financiar në administratën publike , ndërton besim në shpenzimin e fondeve publike dhe luajnë një rol aktiv për rritje të llagaridhënjes së institucioneve publike .

Zyra Kombëtare e Auditimit ka kryer auditimin e RVF për vitin 2023 i cili e përcakton OPINIONIN e dhënë nga auditori i përgjithshëm i cili pasqyron drejt për së drejti cilësin e kontrollit të mbrendshën të përcaktuar nga menagjmenti.

Auditori është fokusuar në :
PVF - Menaxhimi financiar dhe kontrolli dhe rekomandimet e vitit paraprak

OPINIONI – është një pasqyrim i të gjeturave të audituara

Opinionin i auditorit për PVF për vitin e përfunduar 31.12.2023

Ne besojmë se evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë .

Opinionin i auditorit :

„ **OPINION I KUALIFIKUAR PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE** “

Baza për Opinion të Kualifikuar

B1 Përmes pagesave direkte nga Thesari bazuar në vendime gjyqësore gjatë vitit 2023 transaksione në vlerë 436,088€ ishin realizuar për pagat jubilarë dhe shujta nga kategoria ekonomike joadekuate. Prej tyre nga investimet kapitale ishin realizuar 253,717€, nga komunalit 69,798€, si dhe nga subvencionet 112,573€.

Sipa opinionit të ZKA – së për veç ndikimit të çështjeve të përshkruar në paragrafin për bazën për opinion të kualifikuar Pasqyrat Financiare vjetore të Komunes së Vitisë për vitin 2023 prezentojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për sektorin publik sipas kontabilitetit të paras së gatshme. (Faqe 3)

Auditimin është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Intitucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjstit tona janë përshkruar te pjesa e raportit „ përgjegjstit e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare “ në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e etikës së ZKA-së si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatës buxhetore . Besojmë se dëshmit e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzioni i përgjithshëm i auditimit

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të Komunës së Vitisë kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare (shënim i auditorit).

Baza për konkluzion

- B2 Në 26 raste për pagesat për mallra dhe shërbime, zotimi i mjeteve dhe urdhërblertet ishin proceduar pas pranimit të mallit/ faturës.
- B3 Komuna kishte të angazhuar 33 zyrtarë me kontrata për shërbime të veçanta, dhe për ta nuk kishte zhvilluar procedura të prokurimit siç kërkohet me ligjin për zyrtarët publik.
- B4 Në pesë (5) raste faturat/obligimet në vlerë 84,079€ nuk ishin paguar brenda afatit kohorë ligjor prej 30 ditësh.
- B5 Komuna ka përdorë fondet e projekteve për qëllime tjera nga ajo për çka ishin planifikuar, pa i zbatuar procedurat dhe kriteret për transferim dhe rialokim të ndarjeve buxhetore.

Gjatë auditimit, ne kemi vërejtur fusha ku nevojiten përmirësime të dukshme, rreth menaxhimit financiar dhe Kontrollit. Dobësi evidente janë vërejtur në fusha të rëndësishme financiare si: Keq klasifikimi i shpenzimeve si rezultat i pagesave me vendime gjyqësore për zbatim të kontratës kolektive, mangësi në procedim të pagesave, vonesa në pagesën e obligimeve, dobësitë në menaxhimin e pasurive si dhe auditimin e brendshëm të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Gjetjet dhe rekomandimet kanë për qëllim të përmirësojnë informacionin financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik.

Gjithashtu, duhet të theksojmë se për vitin 2023, Thesari kishte ekzekutuar përmes procedurave përmbarimore/gjyqësore vlerën prej 436,088€, prej tyre shpenzime të interesit dhe përmbarimit ishin 158,607€, për obligimet që kanë dalë nga kontrata kolektive. Këto shpenzime kanë të bëjnë me pagesat që janë bërë për shujta për kontratën kolektive

Ky raport ka rezultuar me 9 rekomandime, prej tyre një (1) është rekomandim i ri , shtatë (7) të përsëritura dhe një (1) pjesërisht e përsëritur.

Menagjmenti i komunës ka projektuar dhe zbatuar një sistem të kontrolleve të mbrendshme por disa kontrole të administrimit nuk operojnë në mënyrë efektive duke identifikuar këto rekomandime dhe Kryetari duhet të siguroj për të gjeturat :

- 1 - Çështja B1 - Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve në kategorinë ekonomike
- 2 - Çështja B2 – Urdhër blerjet dhe zotimet pas pranimit të mallit/ faturës
- 3 - Çështja B3 - Angazhimi i punonjësve me kontrata për shërbime të veçanta pa procedura ligjore
- 4 - Çështja B4 - Vonesa në pagesën e obligimeve
- 5 - Çështja B5 - Ekzekutimi i pagesave për projekte të caktuara nga buxheti i projekteve tjera
- 6 - Çështja A1 - Mangësi në databazën e tatimit në prone
- 7 - Çështja B6 - Monitorimi i menaxhimit të kontratave jo përmes E-prokurimit
- 8 - Çështja B7 - Mos mbyllja e investimeve në vijim si dhe regjistrimi i tyre si pasuri në përdoorim
- 9 - Çështja C1 - Mangësi në Sistemin e Auditimit të Brendshëm

Viti
Datë 09.09.2024

Kryetari i Komunës
Sokol Haliti

